

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AUTO-XHE GAZ” SH.P.K.

Sot, më date **19.02.2021**, une i nënshkruarit:

- **Xhesilio Gjolena** lindur me 12/10/2001, shtetas shqiptar, me residence ne Lushnje, fshati Kolonje, mbajtes i leternjoftimit nr.**033584286**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar..; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**AUTO-XHE GAZ**” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**AUTO-XHE GAZ**” **SH.P.K.**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Fshati Kolonje ,godine me nr pasurie 3/101 me zone kadastrale 22/07, rrethi Lushnje, qarku Fier.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *autoxhe@yahoo.it*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqërive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- a. Shitja me pakice e bombulave te mbushura per ngrohje dhe gatim, etj. etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

((1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë



Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues **Z. Xhesilio**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përgjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës percaktohen ne statutin e shoqërise.

Neni 9

Administrimi



Aministrator i shoqerise emerohet Z. **Xhesilio Gjolena** lindur me 12/10/2001, shtetas shqiptar, me residence ne Lushnje, fshati Kolonj, mbajtes i leternjoftimit nr.033584286,, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjastimisht, viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gjë te tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim per nxierien e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cialt eshte i detyruar qe tja paraqese e ta dorëzoje ne kohe ortakëve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM

Xhesilio Gjolena

